



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.406, datë 17.12.2021

**PËR PLOTESIMIN E NJË VAKANCE TË PËRKOHSHME NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SARANDË, NËPËRMJET
PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 5 dhe 6, të Rregullores “Mbi Kriteret dhe Procedurën e Transferimit të Përkohshëm të Prokurorit”, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI :

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e një vakance të përkohshme, për një periudhë një vjeçare, nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim, në :

- Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë

2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



KRYETARI
GENT IBRAHIMI